

Rektori i UP-së pret pjesëmarrësit e garës ndërkombëtare në Vjenë

Rektori Hasani përgëzon studentët fitues në Austri

KOHA
Info

SHKAMB QAVDARBASHA

PRISHTINË, 15 QERSHOR – Studentët të cilët kanë treguar arritje të mëdha në një garë ndërkombëtare në aplikimin në praktikë të njohurive në Austri janë pritur të hënën nga Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani. Rektori shprehu mirënjohjen e tij ndaj këtyre studentëve, si dhe u zotua se UP-ja do ta mbështesë organizatën WUS Austria, e cila kishte mundësuar pjesëmarrjen në garë të studentëve kosovarë.

Këta studentë kanë dëshmuar aftësitë e tyre në fushat e biznesit, drejtësisë, diplomacisë etj., duke shënuar suksesin më të madh nga 12 vendet pjesëmarrëse në këtë garë.

But Dedaj, drejtori ekzekutiv i WUS-Austria në Kosovë, duke theksuar se Kosova ka marrë më së shumti çmime në këtë garë, ka thënë se vendi i dytë në këtë garë “nuk i afrohet as gjysmës së çmimeve që i kemi fituar ne”.

Sipas Dedajt, në këtë konkurs kanë marrë pjesë 142 studentë finalistë nga 12 shtete.

Ardi Shita ka dalë fitues i çmimit për garën në drejtësi. Shita dhe grupi i tij kanë pasur rastin të veprojnë si avokatë para një simulimi të Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, duke përfaqësuar një shtet i cili gjoja ishte vërshtuar nga uji si pasojë e nxehtësisë globale.

“Ka qenë një sfidë, sepse nuk është një çështje që është e rregulluar mirë me të drejtën ndërkombëtare, dhe na është dashur të improvizojmë e të hulumtojmë shumë”, ka thënë Shita, duke folur për rastin e improvizuar. Shita ka marrë si çmim një muaj studime kërkimore në Universitetin e Gratzit.

Lura Limani ka marrë pjesë në një model të Këshillit



të Evropës, duke përfaqësuar Letoninë. Duke e vlerësuar si përvojë të madhe përfaqësimin e një shteti të vogël, Limani ka mësuar se “nuk është me rëndësi masa, po si i prezanton faktet”. Ajo ka marrë çmimin për diplomatin më të mirë, dhe me të një trajnim mbi studimet demokratike në Austri.

Ndërsa në garën e biznesit të tri grupet më të mira, kanë pasur brenda tyre studentë nga Kosova.

Gara është sponsorizuar nga Grupi i Sigurimit të Vjenës. Albulena Xhelili, fituese e çmimit të parë prej 1,000 eurosh, ka thënë se “ka qenë një eksperiencë e jashtëzakonshme, vetë sfida ka qenë eksperiencë”. Ndërsa Baton Mati, marrësi i çmimit të dytë, në punimin e tezës së magistraturës me Grupin e Sigurimit të Vjenës, ka përshkruar pjesëmarrjen si “kënaqësi e posaçme”.

“Ka qenë kënaqësi e posaçme që kemi qenë pjesë e përfaqësisë të Kosovës”, ka thënë ai.

I gjithë ky sukses, sipas drejtorit të WUS-Austria, Dedajt, është “një dëshmi se niveli i studentëve tanë është shumë i mirë, mos të them që është më i mirë se në vendet e rajonit”.

KOHA DITORE ; 15.07.2008